

VENDIM
Nr. 96, datë 22.2.2023

**PËR MIRATIMIN E FORMATIT TË AKTIT ADMINISTRATIV QË VENDOS
MASËN ADMINISTRATIVE DHE LLOJIN E MASAVE, QË PËRBËJNË SHKAK
PËR KUFIZIMIN E HYRJES**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 6, pika 1, shkronja “dh”, e 141, pika 3, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Masat administrative, të cilat përbëjnë shkak për kufizimin e hyrjes, sipas ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, janë, si më poshtë vijon:

- a) Urdhër largimi, nëse në të përcaktohet kufizim lidhur me ndalimin e hyrjes;
- b) Urdhër dëbimi nga autoriteti përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin;
- c) Urdhër dëbimi nga ministri i Brendshëm, si pasojë e shpalljes të të huajt person i padëshiruar.

2. Masat administrative, të parashikuara në nenin 141, të ligjit nr. 79/2021, “Për të huajt”, vendosen nga autoriteti shtetëror përgjegjës vendor, sipas formatit të aktit administrativ, të parashikuar në aneksin nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

ANEKSI NR. 1



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDASHME
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
Departamenti për Kufirin dhe Migracionin
Drejtoria Vendore për Kufirin dhe Migracionin

Nr. 000000000000

_____, më _____

PROCESVERBAL I KONSTATIMIT TË KUNDËRVAJTJES RECORD OF FINDING OF THE OFFENCE

Data, vendi, konstatuesi <i>Date, place, authority</i>	Sot më datë (<i>data, muaji, viti</i>), _____ ora _____, në vendin _____ (<i>emri i plotë i vendit</i>). Today on (<i>date, month, year</i>), _____ at _____ at the place _____ (<i>full denomination of the place</i>). Unë _____ (<i>grada, emri, mbiemri i punonjësit të policisë</i>), me detyrë _____ (<i>funksioni</i>). I _____ (<i>rank, full name of police employee</i>), in the position of _____ (<i>function</i>). Konstatova se: Found: _____
Kundërvajtësi <i>Offender</i>	_____ (<i>emri, atësia, mbiemri i plotë i Kundërvajtësit / first name, father's name, family name of the offender</i>) Pasaporta nr. _____, lëshuar në _____ Passport no. _____, issued on _____ Adresa në Republikën e Shqipërisë _____ (<i>adresa e plotë e kundërvajtësit</i>) Address in the Republic of Albania _____ (<i>full address of the offender</i>)
Shkelja e konstatuar <i>Found violation</i>	Ka shkelur ligjin nr. _____, datë _____, neni _____, pika _____ shkronja _____. Has violated law No. _____, date _____, article _____, paragraph _____ letter _____ _____ _____ _____ <i>Shkruani referencën e ligjit për shkeljen e konstatuar dhe një përshkrim të shkeljes / Write the law reference for the found violation and a description of the offence</i>
Deklaratë <i>Statement</i>	Kundërvajtësi deklaron: <i>Offender statement</i> _____ _____ _____

Për shkaqet e sipërsënuara vendosa:
Considering the foregoing reasons, I decided:

SANKSIONI: Të gjobitet me (_____) lekë.
SANCTION: Imposition of a fine (_____) All.

KUNDËRVAJTËSI (*Emri, mbiemri i kundërvajtësit*) _____
OFFENDER (*First name, family name of the offender*) _____

PËRPILUESI I PROCESVERBALIT _____
(*Grada, emri, mbiemri i punonjësit të policisë*)
RECORD PREPARED BY _____ (*Rank, first name, family name of the police employee*)

Shënim. Likuidimi i gjobës bëhet brenda 10 ditëve nga data që ky akt administrativ ka marrë formë të prerë. Pas kalimit të këtij afati, për çdo ditë vonësë paguhet 2% kamatëvonësë.

Note: Liquidation of the fine is done within 10 days from the date that the decision has become final. After this deadline, 2% late interest is paid for each day of delay.